



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Procesverbal i mbajtur më 13 korrik 2021, në mbledhjen e XLII (pesëdhjetë e dy) - e jashtëzakonshme, të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VI.

Mbledhje e mbajtur në kërkesë të Kryetarit të Komunës së Podujevës, nr.prot.01-060/01-0045996/21 të datës 08 korrik 2021,

Mbledhja filloi në orën 10;15 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve në objekt të Komunës.

Mbledhjen e kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës.

Në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë këshilltarët/et e Kuvendit të Komunës, (Lista e nënshkrimeve), përveç z.Agim Behluli i cili mungoi.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Gjithashtu në mbledhje të pranishëm ishin z.Shpejtim Bulliqi Kryetar i Komunës, znj.Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, Drejtorët e Drejtorive (DPUMM, DKA, DPKGJ, DKRS, DSHMS, DA, DI, DPZHE) të Komunës së Podujevës, media televizive dhe të shkruara, si dhe një numër i zyrtarëve komunal.

Rendi i ditës

z.Fatmir Gashi, Kryesuesi i Kuvendit, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit dhe duke iu dëshiruar punë të mbarë. Shtoi, sigurisht jeni në dijeni nga materialet e dërguara se kjo mbledhje e jashtëzakonshme është thirr në kërkesë të Kryetarit të Komunës nr.prot.01-060/01-0045996/21 të datës 08 korrik 2021, arsyen e kësaj thirrje po ashtu keni mund ta lexoni në materialet e dërguara së bashku me rendin e ditës.

Kuorumi për punë dhe vendimmarrje ekziston andaj mund të vazhdojmë me punë sipas pikave të rendit të ditës e që sigurisht që jeni në dijeni se rendi i ditës në mbledhje të jashtëzakonshme nuk mund të plotësohet apo ndryshohet.

Thërras nga Ekzekutivi i Komunës, Nënkryetaren e Komunës apo drejtorin e Drejtorisë përkatëse që ta marrin fjalën dhe të japin arsyetimin rreth kësaj seance, përkatësisht pikës së parë, e pastaj edhe për pikën tjetër.

1. Projekt Harta Zonale e Komunës së Podujevës 2020 – 2028

➤ Propozim për vënie në shqyrtim publik

z.Bujar Hasani, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit – DPUMM, përshëndeti të pranishmit dhe vazhdoi me paraqitjen e fjalës hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, ndër të tjera theksoi, duke u bazuar në informatën që kam prezantuar në mbledhjen e kaluar rreth Hartës Zonale të komunës së Podujevës dhe tani pas marrjes së konfirmimit nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me të cilët kemi qenë në konsultime të vazhdueshme, ndjehet nevoja për ndryshimet e parashtruara më herët me qëllim që të kemi një hartë zonale të aplikueshme, të jetë një dokument që ankesat e qytetarëve do të merren parasysh, që bizneseve të Podujevës t’iu jepet hapësirë për zhvillim, ndarja e blloqeve në zonën urbane të jetë pa dallime dhe në kushte të barabarta, që bujqësisë t’i jepet prioritet në zhvillim, nevojitet të bëhen ndryshime në këto pika dhe për të gjitha këto nevojitet miratimi nga ana Juaj si Kuvend i Komunës që të vendoset në shqyrtim publik me afat të përshpejtuar prej 15 ditësh duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ 05/2014, neni 8 pika 4.

Edhe njëherë po ju rikujtoj se pikat që do të ndryshohen janë;

Rishikimi i blloqeve dhe etazhitetit në zonën urbane.

Të Rishikohet dispozita e projekt Hartës Zonale bazë, për përfshirjen e ndërtesave bujqësore në tokë bujqësore ashtu siç është e përcaktuar në draft Hartën Zonale të Kosovës.

Të rishikohet kufiri i tokës ndërtimore në fshatrat përreth qytetit (për gjithsej 10 vendbanime).

Të rishikohet koeficienti i ndërtimit në vendbanimet përgjatë rrugës Podujevë-Prishtinë (për gjithsej 12 vendbanime).

Rishikimi i kufirit të zonës së zgjerimit ekonomik.

Po ashtu pas konsultimeve të shumta në Ministrinë e lartëcekur, jemi dakorduar se pas ndryshimeve dhe miratimit final të hartës Zonale të Komunës së Podujevës, duhet të fillohet me hartimin e Planit Zhvillimor Komunal duke u bazuar në Ligjin e ri të planifikimit hapësinor.

Të nderuar anëtar të Kuvendit, për çdo paqartësi eventuale tuajën për çështjet që u than, unë jam i gatshëm t’ju përgjigjem.

z.Hasan Ajeti, në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së, theksoi, jemi sot në këtë seancë të jashtëzakonshme që t’i japim sërish mundësi që dokumenti i projekt Hartës Zonale të Komunës të vëhet sërish në shqyrtim publik ku qytetarët edhe organet administrative të pushtetit lokal të kenë të drejtë që aq sa ligji i lejon të japin vërejtje, sugjerime dhe plotësim ndryshime që do të pasojnë në Hartën Zonale të Komunës së Podujevës.

Ky dokument i cili për rëndësia është kryesori dhe është përgatitur në kohën kur Lidhja Demokratike e Kosovës ka qeverisur në Komunën e Podujevës, mirëpo kërkesa që sot është sjellë për ndryshimin e këtij dokumenti nuk duhet të lexohet/kuptohet se ky dokument do të ndryshohet në substancë dhe jam i prirur të besoj se ndryshim plotësimet që do të bëhen do të jenë në harmoni me interesat e qytetarëve të komunës së Podujevës dhe kuptohet në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Është përgjegjësi dhe kompetencë e organeve të Ekzekutivit të Komunës që pas miratimit nga ana e Kuvendit, t’i vazhdojnë procedurat ligjore dhe në një kohë sa më të shpejtë dhe të shkurtër që procedurat ligjore e lejojnë, për shkak të rëndësisë që ka ta sjellin për miratim këtu në Kuvendin e Komunës.

Shumë të respektuar qytetarë, Grupi i këshilltarëve të LDK, pa marrë parasysh pozicionin politik, në pushtet apo në opozitë, gjithmonë ka qenë dhe do të jetë për vendimeve që janë në të mirë të qytetarëve të komunës, andaj edhe njëherë e përsërisë se e mbështesim propozimin në fjalë.

z.Florent Hasani, në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së, theksoi, duke u bazuar në informatën e prezantuar nga ana e drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe nevojës për ndryshimin e atyre pikave që Harta Zonale e Komunës së Podujevës të jetë një dokument në shërbim të të gjithë qytetarëve të Komunës, ne Grupi i Këshilltarëve të Kuvendit të Komunës së Podujevës nga radhët e LVV-së pajtohem që të merret vendim për vendosjen në shqyrtim publik në afat të përshpejtuar si dhe në një afat sa më të shkurtër të vie në Kuvend për miratim Harta Zonale e Komunës së Podujevës, gjithëherë në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha Grupet e këshilltarëve të këtij Kuvendi.

z.Fatmir Rudari, në emër të Grupit të këshilltarëve të PDK-së, theksoi, duke parë rëndësinë Hartës Zonale si një prej dokumenteve më të rëndësishme të Komunës së Podujevës edhe ne Grupi i këshilltarëve të Kuvendit të komunës së Podujevës nga radhët e PDK-së do ta përkrahim që ky dokument të vëhet në shqyrtim publik dhe të kthehet sa më shpejt të jetë e mundur për miratim në Kuvendin e Komunës si dokument final.

z.Mehmet Gashi, theksoi, edhe pse nuk jam ekspert i urbanizmit kërkova fjalën për shkak të përvojës që kam për një mandat drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, kështu dëshiroj të jap disa sugjerime për këtë dokument i cili është shumë i rëndësishëm, madje përveç Planit Zhvillimor Komunal i cili për nivelin lokal është si kushtetutë nëse mund ta quaj kështu, dokumenti tjetër më i rëndësishëm është Harta Zonale, pastaj vijnë Planet Rregulluese të Hollësishme e kështu me radhë.

Projekt Harta Zonale 2020 – 2028 e Komunës së Podujevës është dokument shumë i rëndësishëm strategjik për Komunën e Podujevës, dokument i cili bazën ligjore e ka te Ligji për planifikimin hapësinor, Udhëzimin Administrativ 24/2015 dhe disa Udhëzimeve Administrative tjera që kanë të bëjnë me përgjegjësitë e planifikimit hapësinor, por si dokumente të cilat mbështesin hartimin e Hartës Zonale janë edhe Planit Zhvillimor Komunal, Planit Rregullues Urban “Qendra” dhe Planit hapësinor i Kosovës, mirëpo gjithashtu gjatë hartimit duhet marrë për bazë edhe shumë ligje tjera, siç janë, Ligji për bujqësi dhe zhvillim rural, Ligji për mbrojtjen e mjedisit, Ligji për ndërtim, Ligji për rrënimin e ndërtimeve pa leje, Ligji për vlerësim strategjik mjedisor, Ligji për zonat ekonomike, Ligji për turizëm, Ligji për mbrojtjen natyrës dhe disa ligje tjera të cilat janë të ndërlidhura në mënyrë të drejtpërdrejt apo në mënyra tjera për zonat rurale.

Pra qëllimi i Hartës Zonale është përmbushja e kërkesës ligjore dhe t’i ofroj qeverisjes komunale një instrument për kontroll përmes të cilit definohen hollësisht ndarja e territorit të Komunës së Podujevës në zona të tilla, hapësira të lira banimi, industri, bujqësi, aktivitete ekonomike ku për secilën zonë do të përcaktohen shfrytëzimet e lejuara dhe të ndaluara të tokës, kushtet zhvillimore dhe ato të ndërtimit si dhe masat e veprimit për periudhën 2020 – 2028.

Unë mund të them se gjatë hartimit të projekt Hartës Zonale ka qenë një proces dhe angazhim shumë i madh si nga stafi i administratës komunale por edhe një përkrahje e madhe nga GIZ-i Gjerman, gjithashtu në këtë dokument kanë dhënë kontribut edhe Departamenti Hapësinor i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në atë kohë tani Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, por në komitete dhe në diskutime/debate që janë mbajtur në terren, mirëpo shkak që ne në atë kohë kemi kërkuar të tërhiqet nga rendi i ditës, kanë qenë disa pakënaqësi, protesta dhe peticione, kështu që ne vet si Grup i këshilltarëve nga radhët e LDK-së kemi propozuar që të shtyhet për një mbledhje të ardhshme pas shqyrtimit të të gjitha atyre kërkesave.

Prandaj sot ashtu siç e potencoj edhe shefi i grupit të këshilltarëve të LDK-së, ne do ta përkrahim që projekt Harta Zonale të del në shqyrtim publik por me disa sugjerime apo vërejtje.

Unë mendoj që ndoshta është mirë që edhe Kryetari i Komunës edhe paraprakisht ta formoj një grup të ekspertëve meqë shumica në këtë Kuvend jemi të profesioneve të ndryshme dhe nuk i përkasim

kësaj fushe, madje edhe pse unë kam qenë drejtor i Drejtorisë në fjalë konsideroj se është bukur vështirë që 175 apo edhe më shumë faqe të këtij dokumenti sigurisht që është bukur vështirë që në mënyrë profesionale të japim mendimet tona, mirëpo kur është grupi i ekspertëve i formuar nga Kryetari do të ishte shumë më lehtë sepse do të na jepnin sqarime dhe shpjegime rreth këtij dokumenti, sepse ka mundësi që edhe gjatë debatit të na japin disa këshilla profesionale.

Kam një pyetje për drejtorin e DPUMM, konkretisht, çfarë është bërë me kërkesën e kompanisë Gjermane e cila ka parashtruar kërkesë për leje për ndërtimin e fabrikës për riciklimin e mbeturinave dhe prodhimin e energjisë së ripërtëritshme në Komunën e Podujevës, projekt sipas të cilit pritet të punësoj mbi 280 punëtor, kurse kostoja totale e projektit është rreth 55 milion euro, publikim të cilin e ka bërë edhe vet Kryetari i Komunës z.Shpejtim Bulliqi edhe pse ky ka shpreh gatishmëri të plotë në përkrahje të këtij projekti qoftë në aspektin administrativ dhe në ofrimin e kushteve infrastrukturore, mirëpo ende nuk ka asgjë.

Tani singërisht para këshilltarëve të Kuvendit por edhe të pranishmëve tjerë që janë këtu po e them se me përfaqësuesin e asaj kompanie kam lidhje familjare dhe jam i informuar për çështjen në fjalë.

Fillimisht kompania në fjalë në vitin 2018 e ka marrë pëlqimin që nuk ka pengesa me Planin Zhvillimor Komunal – PZHK, pastaj ka bërë kërkesë në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe e ka marrë pëlqimin mjedisorë duke përfshirë edhe debatet që janë zhvilluar, ku ajo pjesë është zonë kufitare, kryesisht e klasës 6-7 dhe nuk ka kurrfarë pengese për atë tokë, kështu që pëlqimi është dhënë. Pastaj më 26.11.2020 është bërë kërkesa zyrtare e kompletuar me gjithë dokumentacionin teknik çka kërkohet me ligj dhe nuk e kuptoj përse nuk i është kthyer përgjigje për 3 muaj deri sa ka ardhur delegacioni Gjerman të cilët i ka pritur në takim Kryetari i Komunës dhe i janë falënderuar Kryetarit të Komunës, mirëpo me të gjitha këto që i ceka, sërish nga drejtori i DPUMM apo nga ndokush tjetër që vet drejtori mund ta dijë më mirë, i është kërkuar kompanisë që ta përsërisë kërkesën sepse janë bërë 3 muaj dhe nuk ka mund t'i kthejë përgjigje, por përsërite një kërkesë të re dhe do të lëshohet leja e ndërtimit. Kompania në fjalë ka aplikuar për të dytën herë dhe ka pritur rreth 2 muaj dhe më datë 07.05.2021 është refuzuar me arsyetimin se nuk është në harmoni me Planin Zhvillimor Komunal.

Për këtë po paraqesë edhe pyetje për drejtorin, meqë ato vërejtjet dhe propozimet që i paraqiti drejtori i DPUMM në fjalën hyrëse, edhe pse nuk i kemi parë në material, mirë që i paraqiti, pyes a është e paraparë nga Ekzekutivi edhe çështja e asaj kompanie në projekt Hartën Zonale të Komunës ashtu siç i është premtuar. Unë pasi është kryer kjo çështje kam qenë te Kryetari i Komunës dhe jam interesuar përse ka ndodhur ajo, kam parë një disponim të tij. Prandaj e them se është mirë që këto çështje të sqarohen sepse projekt Harta Zonale do të sjellë sërish në Kuvend për marrjen e vendimit përfundimtar, madje mendoj se është mirë të mbahet edhe ndonjë mbledhje qoftë edhe e jashtëzakonshme në mënyrë që të sqarohen në detaje të gjitha ecuritë e këtyre problemeve.

z.Bujar Hasani, drejtor i DPUMM, theksoi, sa i përket projekt Hartës Zonale për të cilën u tha se duhet bazuar në ligjet e planifikimit hapësinor, ligjit për bujqësi dhe ligjeve tjera përkatëse, fillimisht e them se ne kemi një dokument për të cilin u tha se është si një lloj kushtetute për nivelin lokal e që është Plani Zhvillimor Komunal – PZHK dhe gjatë hartimit të këtij dokumenti duhet të merren për bazë gjitha ato ligje që u ceken, ndërsa është themel i hartimit të Hartës Zonale, madje Ministria përkatëse më së shumti e analizon se a kemi dalë jashtë kufijve të PZHK-së, por me miratimin e tyre-Ministritë e kemi që PZHK-së do ta bëjmë të re dhe me ligj të ri sepse ajo që është aktuale është me ligj të vjetër, mirëpo do të fillojmë pas miratimit të Hartës Zonale dhe do ta hartojmë PZHK-në e re duke u bazuar në ligjin e ri të planifikimit hapësinor, do të thotë se kjo po bie ndesh me ato ligje që u ceken më herët.

Sa i përket ngritjes së grupit të ekspertëve, mendoj që meqë ky shqyrtim është vazhdim i shqyrtimit plotësues të shqyrtimit publik të mëhershëm e që më së mirë do të ishte të aktivizoheshin grupet e mëhershme të ekspertëve të cilat kanë qenë brenda Komunës në mënyrë që me pasë një vazhdueshmëri sepse janë në rrjedha dhe kanë njohuri si shkon procesi, kjo për arsye se nuk kemi edhe kohë shumë për të ngritur grup të ekspertëve.

Sa i përket fabrikës dhe pyetjes se deri ku ka shkuar procesi, para se të vijmë në qeverisje ka pas një aplikim dhe gjatë atij afati në një mënyrë ne i kemi thënë të aplikon edhe njëherë dhe pasi ka aplikuar sërish ne ia kemi refuzuar duke u bazuar në PZHK në fuqi sipas të cilës nuk tregohet për zhvillim apo jo por në bazë të PZHK-së ajo zonë është jashtë zonës së ndërtimit dhe si të tillë ne nuk kemi të drejtë ta trajtojmë sepse ashtu parashihet me PZHK dokument i cili është baza e çdo dokumenti tjetër planifikues. Procesi sipas udhëzimeve tona dhe sipas ankesës si shkallë e parë ka shkuar në Ministri dhe shpresoj se Ministria do të bëjë një zgjidhje për atë problem.

Sa i përket pyetjes se a është përfshirë në propozimet tona për plotësim ndryshim të Hartës Zonale, nuk kemi menduar vetëm për atë kompani por kemi menduar edhe për shumë kompani tjera për të cilat do të parashihen procedura se si do të trajtohen ato lloje të objekteve. Objekti në fjalë për të cilën po diskutojmë nuk është i zakonshëm por është karakteristik por kemi vë kushte për të ardhur deri tek kushtet ndërtimore sepse edhe procesin që e kanë filluar e kanë pasë gabim ngase fillimisht është dashur të pajisen me kushte ndërtimore brenda Komunës sepse kushtet i përcakton Komuna, pastaj duhet të merret leja mjedisore, pëlqim nga zjarrfikësit dhe të tjera të ngjashme, mirëpo ajo kompani ka filluar nga mbrapa (prej bishtit) njëfarë mënyre për t'i ecur punës çka do të thotë se edhe vetë procesi është gabim e që madje edhe për këtë kam pasë mundësi ta rrëzoj/refuzoj, mirëpo kemi ardhur deri te ajo fazë ku lënda është në Ministri e cila besoj se do t'i bëjë zgjidhje, pastaj çfarëdo që vie prej Ministrisë për neve si DPUMM është në rregull pastaj.

z.Mehmet Gashi, theksoi, drejtori i DPUMM mos ta merre këtë si personale, madje për familjen e tij kam respekt edhe pse këtë personalisht nuk e njoh, madje deri sa është emëruar në këtë pozitë nuk e kam njohur fare dhe asnjëherë nuk kam pasur rast të rrijë me të që dua të them se nuk kam asgjë me të, mirëpo unë kam një përvojë 40 vjeçare në administratën e Komunës dhe i di mirë rregullat dhe ligjet, me theks ato të pushtetit lokal.

E vërteta rreth çështjes në fjalë është se PZHK 2016 – 2026 ende është në fuqi, dhe ajo ka nevojë për ndryshime dhe plotësime mirëpo si dokument është në fuqi. Çështja tjetër është se PZHK nuk e ndalon ndërtimin në atë zonë sepse në faqen 250 të PZHK-së sipas pikës 5.4 paragrafi 3 lejohet ndërtimi në tokën e cilësisë së ulët por mbi klasën e 4-të të parcelës për të cilën kërkohet leje ndërtimi, do të thotë kryesisht ka qenë për klasën 5, 6, 7 në atë parcelë, dhe një pjesë e klasës 4 e cila është një mal me sipërfaqe shumë të vogël, por sipërfaqja prej 7 hektarësh, objekti është 4 ari maksimum, do të thotë se ka pasë mundësi ku të dojë në tokën ku është klasa e 7 dhe nuk ka pengesë me PZHK sipas asaj që e parasheh edhe neni përkatës e që tani kjo çështje ka kaluar në Ministri për vendosje, mirëpo është e pakuptimtë nëse një investitor të jashtëm heq dorë kur e kemi interesin dhe se për çfarë numri të punësimeve bëhet fjalë aty.

Po dëgjoj zëra nga kolegët që po thonë se kjo temë që unë po flasë nuk ka të bëjë me pikën e rendit të ditës, mirëpo unë ju them se tema për të cilën po diskutoj ka të bëjë pikërisht me Planin Zhvillimor Komunal dokument i cili ndërlihet drejtpërdrejtë me Hartën Zonale.

z.Bujar Hasani, drejtor i DPUMM, theksoi, ne kemi shumë vendime brenda Drejtorisë të cilat janë marrë në dy standarde njëfarë mënyre, kemi aplikues të cilëve i'u është refuzuar sipas paragrafit që unë e kam refuzuar kërkesën e kompanisë në fjalë, do të thotë kjo është më e fuqishme se sa ajo pika që u cek e cila është tekstuale dhe grafike. Përderisa një investitori i thuhet se nuk lehet ndërtimi sepse është jashtë zonës së ndërtimit, atëherë çka ka përparësi ky ndaj tij, mirëpo unë jam që ta

interpretojmë sa më drejt këtë vendim, por nëse e kam gabim atëherë është Ministria ajo e cila mund të më thotë e ki gabim drejtor sepse mund të ecni përpara me lëndën. Pra pika kryesore në bazë të të cilës unë e kam bërë refuzimin e lejes është se është jashtë zonës së ndërtimit, zonat e ndërtimit janë përcaktuar me PZHK.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, ne u deklaruar se jemi për që dokumenti në fjalë të kaloj në dëgjim publik mirëpo kohëzgjatjen dhe data e mbajtjes së debateve publike të caktohen nga drejtori i DPUMM.

z.Bujar Hasani, drejtor i DPUMM, theksoi, nëse nuk ka çështje tjera, unë do ta paraqes propozim vendimin në fjalë ku përcaktohen të gjitha çështjet rreth shqyrtimit publik, dhe atë si në vijim:

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d), 17 shkronja b) dhe 40.2 shkronja l) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 10 paragrafi 2.2.2, nenit 11 paragrafi 1.12 të Ligjit nr.04/L-174 për planifikimin hapësinor, nenin 7 paragrafi 2, dhe 8 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ nr.05/2014 (MMPH) për përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikimin hapësinor, nenit 13 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.04/2018 për Transparencë në Komuna, Udhëzimin Administrativ (MAPL) nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, neneve 14 dhe 15 parag. 2.4 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, në pajtim me nenin 35 shkronja o), dhe 37 pika 4 të Rregullores së Komunës së Podujevës për mënyrat, procedurat dhe kushtet e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset e vendimmarrjes nr.01/18-02 të datës 31 janar 2011, në zbatim të Planit të Veprimit për Transparencë për periudhën 2019 – 2023 në Komunën e Podujevës, Vendimit të Kuvendit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-948/03-0072034/17 dt.19.09.2017 për fillimin e hartimit të Hartës Zonale, si dhe aktit të vlerësimit të përputhshmërisë me nr.prot.SP-02/7116-2/19 të datës 17.01.2020 të MMPH, Kuvendit të Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 13 korrik 2021 (pra sot) të miraton këtë;

Vendim për vënien në shqyrtim publik

Vëhet në shqyrtim publik; Projekt Harta Zonale e Komunës së Podujevës (HZK) 2020 – 2028, Shqyrtimi publik sipas nenit 1, zgjat 15 ditë dhe fillon nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Shqyrtimi publik mbahet konform dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi, me theks Udhëzimit Administrativ nr.05/2014 (MMPH) për përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikimin hapësinor dhe organizohet nga Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit – DPUMM e cila gjatë kësaj periudhe, ndër të tjera, prezanton pjesën grafike dhe tekstuale të projekt Hartës Zonale të Komunës së Podujevës 2020-2028.

Propozimet, sugjerimet, apo vërejtjet lidhur me dokumentin në fjalë mund të paraqiten gjatë periudhës së shqyrtimit publik përmes debateve të drejtpërdrejta me qytetarë, në formë të shkruar në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit - ndërtesa e re e Komunës, si dhe në formë elektronike në e-mail adresën *(të cilën do ta dërgoj më vonë)* të cilat përcjellën në DPUMM brenda periudhës së shqyrtimit publik.

Dokumentet sipas nenit 1, është pjesë përbërëse e këtij vendimi dhe i njëjti publikohet në ueb-faqen zyrtare të Komunës:

Shqyrtimin publik obligohet ta zbatoj Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, e cila po ashtu përgatit raportin përkatës dhe jep sqarime dhe arsyeshmëri rreth pranimi ose mospranimi të propozimeve dhe sugjerimeve konkrete.

Gjatë periudhës së shqyrtimit publik sipas këtij vendimi, DPUMM bashkëpunon dhe koordinon me Zyrën për marrëdhënie me publikun dhe informim.

Pas përfundimit të shqyrtimit të projekt Hartës Zonale të Komunës së Podujevës 2020-2028, DPUMM ndërmerr të gjitha veprimet e parapara ligjore për finalizimin e dokumentit të HZK-së, dhe procedimit të tij në Kuvendin e Komunës së Podujevës për shqyrtim dhe miratim përfundimtar. Vendimi hyn në fuqi pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, nëse ka të të interesuar tjerë për të marrë fjalën urdhëroni, nëse jo, i vë në votim propozimet e prezantuara nga drejtori i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit për vënie në shqyrtim të projekt Hartës Zonale të Komunës.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri, me 34 vota PËR, miratohen propozimet e drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit – DPUMM, për vënie në shqyrtim publik projekt Hartën Zonale e Komunës së Podujevës (HZK) 2020 – 2028, përfshirë edhe propozimet e në fjalën hyrëse, për plotësim ndryshim të projekt dokumentit bazë (me arsyetimin që të jetë një Hartë Zonale e aplikueshme, që ankesat e qytetarëve të merren parasysht, që bizneseve t’iu krijohet hapësirë për zhvillim, që ndarja e blloqeve brenda zonës urbane të jetë pa dallime dhe në kushte të barabarta, që bujqësisë t’i jepet prioritet në zhvillim), dhe atë:

-Që të rishikohen blloqet dhe etazhitetet në zonën urbane.

-Që të rishikohen dispozitat e projekt Hartës Zonale bazë, për përfshirjen e ndërtesave bujqësore në tokë bujqësore ashtu siç është e përcaktuar në draft Hartën Zonale të Kosovës.

-Që të rishikohet kufiri i tokës ndërtimore në fshatrat përreth qytetit (për gjithsej 10 vendbanime).

-Që të rishikohet koeficienti i ndërtimit në vendbanimet përgjatë rrugës Podujevë-Prishtinë (për gjithsej 12 vendbanime)

-Që të rishikohet kufiri i zonës ekonomike

2. Zëvendësimi i një anëtari të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB, (për shkak të ndërrimit të Komandantit të Stacionit të Policisë në Podujevë)

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, rreth kësaj pike të rendit të ditës kemi të bëjmë me zëvendësimin e një anëtari të KKSB për shkak të ndërrimit të Komandantit të Stacionit të Policisë në Podujevës e që sipas detyrës zyrtare ashtu siç parashihet me Udhëzimin Administrativ përkatës duhet të jetë pjesë e përbërjes së Këshillit në fjalë.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, përshëndeti të pranishmit, theksoi, e potencoj kryesuesi i Kuvendi arsyen e këtij zëvendësimi, mirëpo për mendimin tim vendimet që janë marrë më herët rreth përbërjes së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, anëtarët e këtij këshilli kanë qenë me emër dhe mbiemër gjë që ndoshta nuk ka qenë e rrugës për faktin që prej pozitës zyrtar që e ka Komandanti i Stacionit të Policisë është pjesë përbërëse e KKSB-së, prandaj arsyeja e propozimit për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit përkatës është sepse para disa ditëve është ndërruar Komandanti i Stacionit të Policisë në Podujevë, pra tani e kemi një Komandant të ri dhe tani e tutja sipas detyrës zyrtare Komandanti i Stacionit të Policisë në Podujevë duhet të jetë pjesë e përbërjes së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, prandaj është mirë që sot kur të votohet të merret vendim që pozita, Komandant i Stacionit të Policisë në Podujevë, të jetë pjesë e këtij këshilli, jo me emër dhe mbiemër siç ka qenë deri tani.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën e hedh në votim.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri, me 34 vota për, me vendim miratohet zëvendësimi një anëtar i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB, me rekomandim që në vendim të mos ceket emri i komandantit të stacionit të policisë por vetëm pozita.

Pra z.Isak Ejupi, ish Komandant i Stacionit të Policisë në Podujevë dhe anëtar i deritanishëm në KKSB, zëvendësohet nga Komandanti i Stacionit të Policisë në Podujevë sipas detyrës zyrtare, konform Udhëzimit Administrativ në fuqi.

Meqë nuk pati të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 10;50

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr.01-060/04-0056352/21
Podujevë,
13 korrik 2021**

**Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi**